



Në bazë të nenit 8, të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim, nenit 21, 22, 44 dhe 50, të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 17, pika “d”, pika “d” të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, duke vendosur në kërkesën 05 Nr. 350/02-0144503/18/6 dt. 04.04.2019, të investitorit “Melodia-Ing” shpk, me seli në Prishtinë, me pronar-përfaqësues Astrit Gashi, rr. “Hamdi Gashi” nr. 24, në Prishtinë, për ndryshimin e emrit të pronarit të parcelës kadastrale nr. 930-73 ZK Matiçan, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 11.04.2019, merr këtë:

V E N D I M

PËR NDRYSHIMIN E AKTIT ADMINISTRATIV “VENDIM PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE”
05 NR. 350/02-0144503/18 DT. 05.03.2019

I. Ndryshohet akti administrativ “Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore”, 05 Nr. 350/02-0144503/18 dt. 05.03.2019, i lëshuar nga kjo drejtori, në emër të aplikuesve Shefki Gashi, Lirije Shala dhe Naim Hoxha nga Prishtina, me investitor “Melodia-Ing” shpk, me seli në Prishtinë, dhe me pronar-përfaqësues Astrit Gashi, për cakimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor për ndërtimin e fazës së parë të ndërtesave shumë banesore dhe afariste, në kuadër të parcelës ndërtimore të bllokut urban “T24” të Planit Rregullues “Tophane” në Prishtinë, konkretisht në parcelat kadastrale nr. 4831-0, 4832-0 ZK Prishtinë, në pronësi private dhe pjesë të parcelës kadastrale nr. 4825-0 ZK Prishtinë, në pronësi publike, e propozuar për këmbim me pjesë të parcelës kadastrale nr. 930-73 ZK Matiçan.

II. Ndryshimi nga paragrafi I i këtij vendimi, ka të bëjë me ndryshimin e emrit të pronarit të parcelës kadastrale nr. 930-73 ZK Matiçan, në tërë përmbajtjen e aktit administrativ të referuar, dhe atë në vend të emrit “Naim Hoxha” shënohet “Azemine Gashi”.

III. Me këtë vendim ndryshohet akti administrativ “Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore”, 05 Nr. 350/02-0144503/18 dt. 05.03.2019, dhe i njëjti do të prodhojë efekt juridik nga dita e miratimit të tij.

A r s y e t i m

Aplikuesi “Melodia-Ing” shpk, me seli në Prishtinë, me pronar-përfaqësues Astrit Gashi, me kërkesën 05 Nr. 350/02-0144503/18/6 dt. 04.04.2019, ka kërkuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, ndryshimin e emrit të pronarit emrit të pronarit të parcelës kadastrale nr. 930-73 ZK Matiçan, në aktin administrativ “Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore”, 05 Nr. 350/02-0144503/18 dt. 05.03.2019, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor për ndërtimin e fazës së parë të ndërtesave shumë banesore dhe afariste, në kuadër të parcelës ndërtimore të bllokut urban “T24” të Planit Rregullues “Tophane” në Prishtinë, konkretisht në parcelat kadastrale nr. 4831-0, 4832-0 ZK Prishtinë, në pronësi private dhe pjesë të parcelës kadastrale nr. 4825-0 ZK Prishtinë, në pronësi publike, e propozuar për këmbim me pjesë të parcelës kadastrale nr. 930-73 ZK Matiçan.

Me kërkesën 05 Nr. 350/02-0144503/18/6 dt. 04.04.2019 aplikuesi ka prezantuar këtë dokumentacion: dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale nr. 930-73 ZK Matiçan, kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale., kopjen e “Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore”, 05 Nr. 350/02-0144503/18 dt. 05.03.2019, aktin noterial “Kontratë për shitblerjen e palujtshmërisë”, i redaktuar dhe noterizuar te noteri Isak H. Ademi, në Prishtinë, me LRP. Nr. 485/19, Ref. 1311/19 dt. 15.03.2019 (kopje e pavërtetuar), aktin administrativ “Aktvendim”, me referencë 011-940/01-

0070778/19 dt. 29.03.2019, i Drejtorisë së Kadastrit (kopje e pavërtetuar), aktin noterial “Autorizim i përgjithshëm”, i Azemine Gashit dhenë Astrit GASHIT, i redaktuar dhe noterizuar te noteri Isak H. Ademi në Prishtinë, me LRP.nr.5558/19, Ref. 1681/19 dt. 04.04.2018 (kopje e pavërtetuar), vërtetimin mbi obligimet tatimore, në emër të Azemine Gashit, nr. 77532/19, dt. 04.04.2019 dhe kopjen e pasaportës së Azemine Gashit.

Drejtorja e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës, dokumentacionit të prezantuar, konsultimit të rregullativës ligjore nga lëmi i ndërtimit, planifikimit dhe procedurës administrative, ka konstatuar se me aktin administrativ “Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore”, 05 Nr. 350/02-0144503/18 dt. 05.03.2019, kjo drejtori ka caktuar kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor për ndërtimin e fazës së parë të ndërtesave shumë banesore dhe afariste, në kuadër të parcelës ndërtimore të bllokut urban “T24” të Planit Rregullues “Tophane” në Prishtinë, konkretisht në parcelat kadastrale nr. 4831-0, 4832-0 ZK Prishtinë, në pronësi private dhe pjesë të parcelës kadastrale nr. 4825-0 ZK Prishtinë, në pronësi publike, e propozuar për këmbim me pjesë të parcelës kadastrale nr. 930-73 ZK Matiçan.

Në ndërkohë, sipas dëshmisë mbi pronësinë për parcelën kadastrale nr. 930-73 ZK Matiçan, bazuar në aktin noterial “Kontratë për shitblerjen e palujtshmërisë”, i redaktuar dhe noterizuar te noteri Isak H. Ademi në Prishtinë, me LRP. Nr. 485/19, Ref. 1311/19 dt. 15.03.2019, është ndryshuar pronari i asaj prone, përkatësisht prona ka kaluar nga pronësia në emër të Naim Hoxhës në pronësi të Azemine Gashit.

Andaj, kjo drejtori, duke u bazuar në nenin 8 *Poseduesi i lejes* të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim, ku thuhet se, citoj: “*Nëse poseduesi i lejes ndërtimore ndryshon gjatë ndërtimit, poseduesi i ri i lejes ndërtimore është i obliguar të njoftojë me shkrim organin kompetent që e ka lëshuar lejen ndërtimore, i cili duhet ta reflektojë ndryshimin në leje ndërtimore brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh*”, dhe në nenin 50 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka konstatuar se mund të bëhet ndryshimi i aktit administrativ “Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore”, 05 Nr. 350/02-0144503/18 dt. 05.03.2019, në tërë përmbajtjen e tij, sipas përshkrimit në pikën II të këtij vendimi.

Bazuar në dispozitat ligjore të përmendura, ky organ vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do ti përcillet organit epror – MMPH.

I dërgohet: Aplikuesve/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Pronës, Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, në dosje të lëndës, kësaj drejtorie dhe Qendrës për shërbim me qytetarë.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 Nr. 350/02-0144503/18 DT. 11.04.2019**

Zyrtari,
Nazife Krasniqi



U.d. Udhëheqëse e sektorit,
Lindita Beqiri

